



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1066 Prot.

Tiranë, më 05 / 07 / 2019

V E N D I M

Nr. 86, Datë 05 / 07 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 10, datë 30.01.2019¹, të bërë nga V.K dhe M.K, kundër Zyrës Vendore Arsimore Mat, me pretendimin për diskriminim për shkak të “bindjes politike²”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesja informon se: “Zyra Arsimore Mat me shkresën nr.593, datë 15.11.2017 ka shpallur konkurim për pozicionin: Drejtor i Shkollën së Mesme të Bashkuar Suç. Në konkurim janë kualifikuar 3 aplikantë: U.D, V.Gj dhe M.K, kandidati V.K është skualifikuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit. Komisioni i Vlerësimit ka bërë vlerësimin e aplikantëve dhe në përfundim ka vlerësuar në vend të parë U.D me 214.5 pikë dhe në vend të dytë M.K me 79 pikë. ZA Mat me shkresën nr.662, datë 20.12.2017 ka njoftuar M.K për të dhënë intervistën në datë 21.12.2017, ora 13.00. Njoftimi për M.K është bërë nëpërmjet shërbimit postar ku sipas konfirmimit rezulton se M.K ka marrë dijeni për njoftimin me datë 23.12.2017. Përgjegjësja e ZA Mat ka realizuar intervistën vetëm me kandidatin U.D dhe nuk ka realizuar intervistën me M.K dhe nuk ka shpallur rezultatet e konkurimit në mjediset e ZA Mat e në web, veprime këto që janë në shkelje të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit nr.57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”. Gjithashtu, emërimi i U.D në pozicionin e drejtorit është bërë në kundërshtim me ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit nr.57, datë

¹ Ankesa është dorëzuar në datë 21.12.2018 dhe është plotësuar me dokumentacion në datë 30.01.2019.

² Referuar shkresës nr.02, datë 19.02.2018, Vërtetim të lëshuar nga subjekti politik: “Partia Demokratike e Shqipërisë” Dega Mat, M.K është sekretare e Lidhjes Demokratike të Grave, Dega Mat, dhe anëtare e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Klos.

12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, pasi U.D me Urdhërin nr. 36, datë 06.10.2017 është komanduar nga ZA Mat si drejtor shkollë në SHMB Suç. ZA Mat me datë 15.11.2017 ka hapur procedurat e konkurimit për vendin vakant të drejtorit të SHMB Suç dhe pranimi i dokumenteve do bëhej nga data 16.11.2017 deri në datë 27.11.2017. Rezulton se U.D me Urdhërin nr.51, datë 05.12.2017 të ZA Mat është pezulluar nga detyra si drejtor i shkollës deri në përfundim të procedurave të konkurimit, pra U.D ka dorëzuar dokumentacionin pas afatit të përcaktuar dhe gjatë procedurave të konkurimit ka ushtruar detyrën e drejtorit të komanduar. Gjithashtu, U.D me datë 05.11.2017 ka marrë masë disiplinore për pezullim nga detyra dhe regjistrimi i tij si konkurent për postin e drejtorit është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.57, datë 12.11.2013”.

Në vijim të ankesës, subjekti ankues informon se: “Në datë 21.12.2017 është caktuar intervista për dy kandidatët fitues, U.D dhe M.K dhe po me datë 21.12.2017 nga përgjegjësjë e ZA Mat është emruar si drejtor U.D. Duke qenë se nuk ka patur të shpallur vendim lidhur me rezultatin e konkurimit për vendin vakant të drejtorit nga ZA Mat, as në mjediset e ZA Mat, as në web, as në mjediset e shkollës, dhe as të jetë vënë në dijeni anëtarët e komisionit të vlerësimit të dosjeve dhe kandidati i shpallur në vend të dytë për rezultatin. M.K ka paraqitur ankim pranë ZA Mat duke pretenduar shkelje procedurale në konkurim dhe për pasojë përsëritjen e konkurimit, por nuk është marrë asnjë përgjigje nga ZA Mat. Referuar Udhëzimit nr. 57, Kreu E, titullari i institucionit nuk mund të bëjë emërimin e kandidatit fitues pa kaluar afati 3 ditor i paraqitjes së ankimit të kandidatit që nuk ka fituar. Është paraqitur ankim në MASR për shkelje të procedurës së konkurimit, dhe me sa ka dijeni është verifikuar rasti nga ana e MASR, por nuk ka marrë asnjë përgjigje”.

Subjekti ankues shpjegon se: “Veprimet e kryera nga komisioni i ZA Mat kanë cenuar të drejtën e saj për barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë para tij për shkak të bindjeve politike, duke i mohuar të drejtën për punësim e konkurim pasi, Përgjegjësjë e ZA Mat është anëtare e kryesisë së Partisë Socialiste, Dega Mat, ndërsa ankuesja është anëtare e Partisë Demokratike dhe Sekretare e Forumit Demokratik të Gruas, Dega Mat”.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale në lidhje me subjektin/et kundër të cilëve ishte drejtuar ankesa dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 07.02.2019, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime lidhur me subjektin/et kundër të cilëve ishte drejtuar ankesa dhe lidhjes shkakësore të trajtimit të pabarabartë me punonjësit e tjerë të ZA Mat si dhe kopje të ankesës drejtuar MASR për kundërshtimin e procedurës së konkurimit për postin e drejtorit.
- Me e-mail-in datë 11.02.2019, ankuesi V.K ka njoftuar heqjen dorë nga ankimi, pasi do ta zgjidhë ankesën e tij në rrugë gjyqësore.
- Me e-mail-in datë 11.02.2019, ankuesja M.K ka dërguar shtesë ankimi si parashtuar më sipër.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përsëritjen e procedurave të konkurimit për pozicionin: Drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 10, datë 30.01.2019 të M.K u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 156/1, datë 14.02.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga ZA Mat për ankesën e bërë nga M.K si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për vlerësimin e aplikantëve nga Komisioni i Vlerësimit dhe titullari i ZA Mat sipas procedurës së përcaktuar në Udhëzimin

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

nr.57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.

- Kopje të vendimit të komandimit, pezullimit dhe emërimit të U.D.
- Informacion se si është trajtuar ankesa e M.K nga ZA Mat dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për shkelje të procedurës së konkurimit për pozicionin e drejtorit dhe kopje të shkresave (nëse ka).

Me shkresën nr. 86/1, datë 26.02.2019, ZA Mat në mes të tjerash informoi si më poshtë:

- Ish Përgjegjësja e ZA Mat, A.R në datë 24.01.2019 është pezulluar nga detyra dhe më datë 12.02.2019 është larguar nga detyra e Përgjegjëses së ZA Mat.
- Lidhur me pretendimin për njoftim me vonesë për intervistën, sqarojmë se: *“Data e shënuar në dokumentacionin postar “Lajmërim marrje” nuk është qartësisht e kuptueshme, po kështu personi nënshkrues i marrjes së objektit postar është K.K (vjehtëri i M.K), gjithashtu rezultatet e konkurimit për postin e drejtorit të shkollës janë shpallur në mjediset publike të ZA Mat, në përputhje me Udhëzimit 57/2013”.*
- Lidhur me pretendimin se, emërimi i U.D në pozicionin e drejtorit është bërë në kundërshtim me ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit nr.57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, pasi U.D me Urdhërin nr. 36, datë 06.10.2017 është komanduar nga ZA Mat si drejtor shkollë në SHMB Suç, sqarohet se: *“U.D nuk mund të privohet nga e drejta e konkurimit për një pozicion drejtues vetëm për faktin se ai ka qenë i komanduar në atë pozicion deri në hapjen e procedurave të emërimit, përderisa kjo gjë nuk është e parashikuar në asnjë akt normativ e ligjor në RSH”.*
- Lidhur me pretendimin se, U.D ka dorëzuar dokumentacionin pas afatit të përcaktuar dhe gjatë procedurave të konkurimit ka ushtruar detyrën e drejtorit të komanduar, sqarohet se: *“Afati i pranimit të dokumentacionit të aplikantëve është shtyrë për shkak të VKM nr.698, datë 23.11.2017, dhe për shkak të kushteve të rënda të motit që çuan në ndërprerjen e procesit mësimor. Dhe aplikantët, M.K, V.K sipas vërtetimit të lëshuar nga ZA Mat rezultojnë që e kanë dorëzuar dokumentacionin e konkurimit më datë 06.12.2017. Po kështu nuk qëndron dhe pretendimi se U.D gjatë procedurave të konkurimit ka ushtruar detyrën e drejtorit të komanduar, nga data 05-21.12.2017 pasi në këtë periudhë ka qenë i pezulluar, si dhe Specialisti i personelit me procesverbalin nr.634, datë 06.12.2017 i ka dorëzuar për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit dosjet e 4 aplikantëve për konkurim. Pra, kuptohet që Komisioni ka nisur punën pas datës 05.12.2017. Gjithashtu, ankuesit në datë 13.12.2017 janë pajisur me vërtetim nga shkolla të lëshuar nga drejtori i komanduar në atë kohë T.P”.*
- Lidhur me pretendimin se, U.D me datë 05.11.2017 ka marrë masë disiplinore për pezullim nga detyra dhe rregjistrimi i tij si konkurent për postin e drejtorit është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.57, datë 12.11.2013, sqarohet se: *“ZA Mat nuk ka marrë masë disiplinore për U.D por Urdhri nr.51, datë 05.12.2017, është lëshuar me qëllim që U.D (si drejtor i komanduar) të mos kishte mundësi ndikimi në*

procesin e konkurimit, duke garantuar kështu cilësinë e procesit. Pra, ky është një element procedure dhe nuk bëhet fjalë për masë disiplinore”.

- Lidhur me pretendimin se, veprimet e kryera nga Komisioni i ZA Mat kanë cenuar të drejtën e ankueses për barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë para tij për shkak të bindjeve politike, duke i mohuar të drejtën për punësim e konkurim pasi, Përgjegjësja e ZA Mat është anëtare e kryesisë së Partisë Socialiste, Dega Mat, ndërsa ankuesja është anëtare e Partisë Demokratike dhe Sekretare e Forumit Demokratik të Gruas, Dega Mat, sqarohet se: *“A.R që nga momenti i emërimit në pozicionin “Përgjegjës i ZA Mat” e deri në largimin nga kjo detyrë, nuk ka qenë pjesë në asnjë prej forumeve drejtuese të Partisë Socialiste apo të ndonjë partie tjetër. M.K rezulton se në zgjedhjet vendore të vitit 2015 është regjistruar si kandidatë për anëtare e Këshillit Bashkiak Klos në listën emërore të subjektit politik “Partia Bashkimi Demokrat” (dhe jo nga Partia Demokratike). U.D, në zgjedhjet vendore të vitit 2011 dhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 ka qenë anëtar i grupit të numërimit të votave si përfaqësues i Partisë Demokratike. Po kështu U.D në periudhën e qeverisjes së Partisë Demokratike (2005-2013) ka qenë drejtor i një shkolle (9-vjeçare), relativisht larg vendbanimit të tij, ndërsa sot është drejtor i një shkolle të mesme të bashkuar shumë afër vendbanimit të tij, pra nuk është diskriminuar për shkak të bindjes politike, nga ana e ZA Mat, por është emëruar në sajë të një konkurimi të rregullt e të paanshëm”.*

Me shkresën nr. 439, datë 20.03.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga MASR, informacion lidhur me trajtimin e ankesës së M.K për shkelje të procedurës së konkurimit për pozicionin e drejtorit. Përsëri nuk ka përgjigje nga ana e MASR.

Me shkresën nr.422/1, datë 01.04.2019, Komisioneri ka vënë në dispozicion të subjektit ankues kopje të akteve të ankesës.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 10, datë 30.01.2019, Komisioneri me shkresën nr. 439/1, datë 09.04.2019 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 16.04.2019.

Në seancë dëgjimore si përfaqësues të palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa, ishin prezent: Sh.T, U.D dhe N.S përfaqësues të ZA Mat dhe subjekti ankues, M.K e përfaqësuar nga bashkëshorti, V.K.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Subjekti ankues, parashtroi dhe një herë pretendimet e tij, në të cilin theksoi se ka dorëzuar dokumentacionin për aplikim për postin e drejtorit të shkollës brenda datës 27.11.2017. Ankuesi

theksoi faktin se ZA Mat ka qenë në shkelje të pikës C/1 të Udhëzimit nr.57, datë 12.11.2013, kur ka bërë komandimin në detyrën e drejtorit të shkollës të kandidatit për drejtor, U.D, pasi ky i fundit mbante postin e nëndrejtorit të shkollës dhe bazuar në udhëzimin e sipërcituar mund të kryente detyrat e drejtorit të shkollës. Ankuesi deklaroi⁴ dhe njëherë se nga ana e ZA Mat nuk është shpallur rezultati përfundimtar i konkurimit në mënyrë që ajo të kishte mundësi të kontestonte rezultatet e vlerësimit të dosjes. Gjithashtu, njoftimi datë 20.12.2017 për të marrë pjesë në intervistën me gojë me titullaren e ZA Mat në datë 21.12.2017, si kandidate me më shumë pikë gjatë procesit të konkurimit, i është komunikuar me datë 23.12.2017, pra dy ditë pas zhvillimit të intervistës. ZA Mat ka vazhduar procedurën e intervistimit dhe në datë 21.12.2017, pra ditën e intervistës ka bërë dhe emërimin në detyrën e drejtorit të U.D, pa marrë parasysh se kandidati tjetër nuk ishte njoftuar, nuk ishte shpallur rezultati i konkurimit si dhe nuk ishte dhënë mundësia për të ndjekur procedurën e ankimit, e cila është, brenda tri ditëve nga shpallja e kandidatit fitues. Ankuesi theksoi faktin se U.D⁵ është anëtar i subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”, i cili bën pjesë në organizatën e fshatit Baz, i pranuar në Partinë Socialiste që në vitin 2016.

U.D, gjatë deklarimit⁶ të tij u shpreh se gjatë periudhës kur janë hapur procedurat për konkurim për pozicionin e drejtorit të shkollës “Haxhi Lata”, ai ka qenë i komanduar në detyrën si drejtor, deri në përfundim të procedurave të konkurimit dhe në përmbushje të ambicjeve të tija, duke parë se nuk kishte asnjë pengesë për të konkuruar, në datë 04.12.2017 ka vendosur për të dorëzuar dosjen e dokumenteve për të konkuruar për pozicionin e drejtorit të shkollës. Me Urdhrin nr.51, datë 05.12.2017 është pezulluar nga detyra e drejtorit të shkollës deri në përfundim të procedurave të konkurimit. Lidhur me pretendimin se janë dorëzuar dokumentet jashtë afatit ligjor, në datë 07.12.2017, U.D deklaroi se ankuesi i referohet datës kur ZA Mat ka dorëzuar dosjet e konkurrentëve, Komisionit të Vlerësimit, dhe nga data 05.12.2017 në pozicionin e drejtorit të shkollës ka qenë e komanduar nëndrejtoresha e shkollës T.P. U.D deklaroi se njoftimin për zhvillimin e intervistës në ZA Mat në datë 21.12.2017, e ka marrë nëpërmjet shërbimit postar në datë 20.12.2017. U.D deklaroi⁷ se nuk ka qenë asnjëherë anëtar i Partisë Socialiste në fshatin Baz por përkundrazi ka marrë pjesë si anëtar i grupit të numërimit të votave, si përfaqësues i Partisë Demokratike. U.D deklaroi⁸ se në mjediset e shkollës është shpallur rezultati i konkurimit për pozicionin e drejtorit po ashtu i është komunikuar dhe kolektivit të shkollës, ashtu siç është parashikuar në Udhëzimin 57/2013.

Nga ana e Komisionerit, u la si detyrë⁹ që në vijim, nga ZA Mat të dërgojë dokumentacion mbi shtyrjen e afatit të dorëzimit të dosjeve nga kandidatët për pozicionin e drejtorit nga data 27.11.2017 deri në datë 04.12.2017, dokumentacion provues mbi njoftimin dhe marrjen dijeni nga M.K për intervistën e datës 21.12.2017, kopje të pezullimit dhe largimit të A.R nga detyra e Përgjegjësës së ZA Mat, si dhe shpjegime nëse kanë patur problematikë të ngjashme në raste të tjera, gjatë procedurave të konkurimit për pozicionin drejtor shkolle.

⁴ Referuar minutës 11.10 e në vijim të regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁵ Referuar minutës 14.02 të regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁶ Referuar minutës 26.10 e në vijim të regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁷ Referuar minutës 33.03 e në vijim të regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁸ Referuar minutës 42.40 e në vijim të regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁹ Referuar minutës 43.25 e në vijim të regjistrimit të seancës dëgjimore.

- Me shkresën nr. 1991/2, datë 16.04.2019, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, informoi Komisionerin në lidhje me pretendimet e M.K për procesin e konkurimit për mësuese e lëndëve Biologji-Kimi të zhvilluar në periudhën, shtator-tetor 2017, çështje për të cilën Komisioneri ishte shprehur me Vendimin nr.119, datë 07.05.2018 dhe nuk kishte dhënë asnjë informacion lidhur me pretendimet e ankueses për procedurën e konkurimit për pozicionin e drejtorit të SHMB “Haxhi Lata” Suç në periudhën nëntor-dhjetor 2017.
- Me shkresën nr. 308, datë 18.04.2019, ZA Mat, ka vënë në dijeni Komisionerin se ka kërkuar nga MASR marrjen e raporteve të inspektimit të kryera nga grupe pune të MASR dhe ISHA-s me Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it nr. 259, datë 19.05.2016 “Për vlerësimin e ligjshmërisë në zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga ZA Mat” dhe me Urdhrin tjetër nr. 352, datë 27.06.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e një hetimi administrativ në ZA Mat dhe shkollën e mesme të bashkuar “Haxhi Lata” Suç, në lidhje me mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit në këtë shkollë”.
- Me shkresën nr. 310, datë 19.04.2019, ZA Mat, ka dërguar pranë Komisionerit materialet e kërkuara gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.
- Me shkresën nr. 156/3, datë 19.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar përsëri nga MASR, informacion lidhur me trajtimin e ankesës së M.K për shkelje të procedurës së konkurimit për pozicionin e drejtorit të SHMB “Haxhi Lata” Suç në periudhën nëntor-dhjetor 2017.
- Me shkresën nr. 630, datë 24.04.2019, Komisioneri ka vënë në dispozicion të subjektit ankues kopje të dosjes së dokumenteve të U.D.
- Me shkresën nr. 1991/5, datë 03.06.2019, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, informoi Komisionerin se: *“Përsa i përket trajtimit të ankesës së M.K për shkelje të procedurës së konkurimit për pozicionin e drejtorit të SHMB “Haxhi Lata” Suç, në periudhën Nëntor-Dhjetor 2017, ju informojmë se nga ana e MASR nuk është vijuar me kthimin e përgjigjes, pasi çështja ka qenë objekt gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë me Vendimin nr. 80-2017-3366, datë 25.07.2017, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova”. Kundër këtij vendimi është bërë ankim nga V.K në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Nuk ka njoftim në lidhje me vendimin e marrë nga Gjykata Administrative të Apelit, Tiranë”.*
- Në datë 14.06.2019, subjekti ankues ka dorëzuar pranë Komisionerit disa dokumente në mbështetje të pretendimeve të tija dhe ka shpjeguar se: *“Në procedurën për konkursin e pozicionit drejtor i shkollës Suç, në datë 05.06.2016, ZA Mat ka ndjekur procedurë të ndryshme përsa i përket rregjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurim dhe shpalljes së fituesve pas intervistës së kandidatëve me më shumë pikë¹⁰”.*
- Me shkresën nr. 6043/1, datë 24.06.2019 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit, MASR, informoi Komisionerin se, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë i ka bërë me dije MASR-së, se nuk është planifikuar një datë për zhvillimin e procesit gjyqësor, lidhur me

¹⁰ Referuar Procesverbalit datë 14.06.2019.

Vendimin nr. 80-2017-3366, datë 25.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Zyra Arsimore Mat me Urdhrin nr.36, datë 06.10.2017 “Për komandim në detyrë” ka urdhëruar U.D me detyrë nëndrejtor në shkollën “Haxhi Lata”, Suç të komandohet drejtor i kësaj shkolle deri në përfundim të procedurave të emërimit të drejtorit. ZA Mat me shkresën nr.593, datë 15.11.2017 ka njoftuar për shpalljen e konkursit për pozicionin: Drejtor i Shkollën së Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata”, Suç dhe pranimi i dokumenteve do bëhej nga data 16.11.2017 deri më datë 27.11.2017. Me Vendimin nr. 698, datë 23.11.2017 “Për caktimin e ditës së Hënë, datë 27.11.2017, ditë pushimi”, Këshilli i Ministrave ka vendosur caktimin e ditës së Hënë, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nëpërmjet faqes së saj në facebook, në datë 30 Nëntor 2017 ka njoftuar pezullimin e procesit mësimor në datë 01.12.2017, në të gjitha institucionet arsimore të arsimit parauniversitar për shkak të reshjeve të dendura. ZA Mat me Urdhrin nr.51, datë 05.12.2017 “Për pezullim nga detyra” ka urdhëruar pezullimin e U.D si drejtor i komanduar i shkollës Suç, deri në përfundim të procedurave të konkursit dhe detyrat e drejtorit të shkollës do t’i kryente nëndrejtori i shkollës T.P. Në datë 05.12.2017 nga ana e Këshillit të Mësuesve të SHMB “Haxhi Lata” Suç, është mbajtur procesverbali mbi rezultatet e votimit për mësuesit anëtarë të komisionit të vlerësimit në procesin e konkurimit për pozicionin, drejtor i shkollës. Në datë 06.12.2017 nga ana e Specialistit të Personelit të ZA Mat dhe Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit, është mbajtur procesverbali nr. 634 për dorëzimin e dosjeve të aplikantëve që kishin paraqitur dosje dhe që do të konkuronin për pozicionin e drejtorit të shkollës “Haxhi Lata” Suç. Me shkresën datë 18.12.2017, Komisioni i Vlerësimit të dosjeve të aplikantëve i ka kthyer përgjigje M.K lidhur me ankimin e saj, se nuk janë ndjekur procedurat në lidhje me mosshpalljen e rezultateve të detajuara të aplikantëve në konkurim. ZA Mat me shkresën nr. 662, datë 20.12.2017 ka njoftuar M.K për të dhënë intervistën lidhur me platformën për drejtimin e institucionit, në datë 21.12.2017, ora 13.00. Me Vendimin nr. 24, datë 21.12.2017, “Për emërim në detyrë”, ZA Mat në përfundim të zhvillimit të intervistës me kandidatin U.D, ka vendosur emërimin e këtij të fundit në detyrën drejtor në shkollën e Mesme të Bashkuar “Haxhi Lata” Suç, dhe marrëdhëniet financiare t’i fillonin më datë 21.12.2017.

Pretendimi i subjektit ankues për diskriminim dhe për parregullsi në ndjekjen e procedurave, nga ana e ZA Mat i ka filluesat që në momentin e afatit të dorëzimit të dokumenteve për konkurim në pozicionin e drejtorit të shkollës deri në momentin e shpalljes së kandidatit fitues. Lidhur me

çështjet e sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se ZA Mat ka barrën e provës¹¹ të provojë që pretendimet e ngritura nga subjekti ankues janë kryer për arsye të ligjshme dhe të justifikuar dhe jo për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

Në analizë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët lidhur me afatin e dorëzimit të aplikimeve për pozicionin e drejtorit të shkollës, vlerësohet se ky proces nuk ka qenë transparent, pasi ZA Mat nuk arriti të vinte në dispozicion të Komisionerit, dokumentacion që të faktonte shtyrjen e datës së dorëzimit të dokumenteve nga ana e aplikantëve deri në datë 04.12.2017, dhe se data 30 nëntor 2017 ka qenë ditë pushimi. Referuar dokumentacionit që disponon Komisioneri, rezulton se datat 27, 28, 29 nëntor dhe data 1 dhjetor kanë qenë ditë pushimi, por nuk rezulton dokumentacion që të faktojë që data 30 nëntor 2017 të ketë qenë ditë pushimi. Gjithashtu, ZA Mat nuk arriti të faktonte se në cilën datë ishte bërë dorëzimi i dokumenteve nga aplikantët. Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioneri në shqyrtim të ankesës nr.111/2016, lidhur me procedurën e konkurimit të zhvilluar për pozicionin e drejtorit të shkollës në datë 05.09.2016, vlerësohet se në dokumentet e shqyrtuara nga grupi i inspektimit¹² rezulton se në atë procedurë ka të administruar dhe procesverbalin e ZA Mat, datë 16.09.2016 “Për dorëzimin e dosjeve të 4 aplikantëve për pozicionin drejtor i SHMB Suç”, si dhe procesverbali datë 16.09.2016 i mbajtur nga Specialisti i Personelit në ZA Mat për dorëzimin e dosjeve të aplikantëve që konkuruar për drejtor të shkollës, Suç. Pra, rezulton se nuk janë ndjekur të njëjtat procedura për të njëjtin proces konkurimi.

Lidhur me pretendimin për mosnjoftimin e M.K për intervistën në datë 21.12.2017, Komisioneri vlerëson se, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, provohet se M.K nuk është njoftuar në kohë për të dhënë intervistën me Përgjegjësen e ZA Mat. Lidhur me këtë fakt, ZA Mat vuri në dispozicion të Komisionerit, dokumentin Lajmërim Marrje Poste, me referencë: RR 090264768 AA, e cila referuar sistemit online të gjurmimit të Postës Shqiptare, rezulton se objekti është marrë në dorëzim në datë 26.12.2017 në orën 12.05. Ndërsa, referuar dokumentit të vënë në dispozicion nga ankuesi: Lajmërim Marrje Poste, me referencë: RR 090264754 AA, e cila referuar sistemit online të gjurmimit të Postës Shqiptare, rezulton se objekti është marrë në dorëzim në datë 23.12.2017 në orën 12.20. Pra, rezulton se ZA Mat nuk ka njoftuar në kohë kandidaten M.K për të zhvilluar intervistën me gojë duke i mohuar mundësinë e konkurimit për postin e drejtorit të shkollës.

Në pikat E/4/5/6 të Udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të Drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, përcaktohet se: “4. Brenda pesë ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit nga komisioni, titullari i njësisë arsimore vendore shpall në një vend publik të njësisë arsimore vendore kandidatin e përzgjedhur për drejtor. 5. Kandidati që nuk ka fituar, ka të drejtë t’i paraqesë ankesë titullarit të njësisë

¹¹Kodi i Punës në neni 9 “Ndalimi i diskriminimit, pikat 9 dhe 10 e tij parashikojnë se: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

¹² Referuar procesverbalit nr.658/2, datë 14.02.2017 të grupit të inspektimit të Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit.

arsimore vendore brenda tri ditëve nga shpallja e kandidatit fitues. 6. Titullari i njësisë arsimore shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda dy ditëve pas përfundimit të afatit për ankim”. Pra siç shikohet, ligji ka parashikuar një procedurë dhe afate, lidhur me shpalljen dhe të drejtën e kandidatëve për ankim, procedura të cilat nuk janë respektuar nga ana e ZA Mat për kandidaten M.K, pasi ajo nuk është njoftuar për procesin e intervistës si dhe nuk i është dhënë mundësia për të ankimuar vendimmarrjen e ZA Mat.

Nga ana e ZA Mat nuk u sollën prova dhe argumente bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se mosnjoftimi për intervistë të kandidates dhe mosdhënia e mundësisë për ankim, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Tendenca e ZA Mat për përzgjedhjen e U.D në detyrën e drejtorit të shkollës, vërehet dhe në veprimin e komandimit të U.D në postin e drejtorit në datë 06.10.2017, rreth 40 ditë përpara shpalljes së konkursit për drejtor shkolle. Në pikën C/1 të Udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të Drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, përcaktohet se: *“Kur drejtori i institucionit publik të arsimit parauniversitar nuk e ushtron përkohësisht detyrën e tij, ai zëvendësohet nga nëndrejtori.....”*. Përsa më sipër, vlerësohet se U.D dhe pa marrë vendimin për komandim, bazuar në legjislacionin e sipërcituar mund të kryente funksionin e drejtorit dhe në pozicionin si nëndrejtor i shkollës.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, vlerësohet se nga ana e Zyrës Arsimore Mat nuk janë respektuar procedurat e emërimit të drejtorit të shkollës sipas Udhëzimit nr. 57, datë 12.11.2013 *“Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të Drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*, në lidhje me procedurat e emërimit të drejtorit të shkollës “Haxhi Lata”, Suç.

Në analizë përsa më lart, Komisioneri vlerëson se ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të paligjshëm nga ana e ZA Mat, duke filluar nga mosnjoftimi për intervistë dhe duke vijuar me mosdhënien e mundësisë për tu ankuar për fituesin e konkurimit.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën e subjektit ankues pretendohet diskriminim, për shkak shkak të “bindjeve politike” nga ana e ZA Mat.

“Bindja politike” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë nga hetimi, Komisioneri konstaton se subjekti ankues ka provuar se mbart shkaku e pretenduar.

- a) Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, subjekti ankues ka provuar se ka bindje të djathta politike, pasi:
- Referuar shkresës nr.02, datë 19.02.2018, Vërtetim të lëshuar nga subjekti politik: “Partia Demokratike e Shqipërisë” Dega Mat, M.K është sekretare e Lidhjes Demokratike të Grave, Dega Mat.
 - Me shkresën nr. 339/1, datë 22.02.2019 të lëshuar nga Këshilli i Bashkisë Klos, provohet se M.K, me Vendimin nr.9, datë 23.01.2018 ka marrë mandatin e këshilltares në Këshillin e Bashkisë Klos si përfaqësuese e subjektit politik “Partia e Bashkimi Demokrat”.

Pra, nga sa shihet ankuesja i ka të ekspozuara bindjet e saj politike, të cilat dhe i ka dokumentuar shkresërisht.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e ZA Mat, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Me Vërtetimin nr. 02, datë 22.02.2019 të lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratike, Dega Mat, vërtetohet se U.D në zgjedhjet vendore të vitit 2011 dhe ato për Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2013, ka qenë anëtar i Grupit të Numërimit të Votave pranë KZAZ-së, nr.16 Burrel, si përfaqësues i Partisë Demokratike, Dega Mat.
- Të njëjtin qëndrim për bindjet politike të ankueses, ka mbajtur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe gjatë shqyrtimit të ankesës nr.134/2017, kur me Vendimin nr.119/2018 ka arsyetuar se: *“..nuk kemi trajtim të pafavorshëm të ankueses për shkak të bindjeve të djathta politike, nga ana e ZA Mat, për faktin se edhe drejtuesi i SHMB Suç ka bindje të djathta politike, dhe ky nuk mund të qëndrojë si fakt për të provuar se diskriminimi i M.K ka ardhur si pasojë e bindjeve të saj politike”.*

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nuk kemi trajtim të pafavorshëm të ankueses për shkak të bindjes së djathtë politike, nga ana e ZA Mat, për faktin se edhe kandidati tjetër për pozicionin e drejtorit të shkollës “Haxhi Lata”, Suç, U.D ka bindje të djathta politike, dhe ky shkak nuk mund të qëndrojë si fakt për të provuar se diskriminimi i M.K ka ardhur si pasojë e bindjeve të saj politike.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me*

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e ZA Mat, por nuk u gjenden prova dhe fakte të vërtetojnë lidhjen objektive ndërmjet këtij trajtimi dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se ZA Mat nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të për shkak të bindjes politike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të M.K nga ana e ZA Mat për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA